

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Një grup i rrallë infeksionesh gjatë shtatzënisë rrit rrezikun e autizmit
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/29/nje-grup-i-rralle-infeksionesh-gjate-shtatzenise-rrit-rre-zikun-e-autizmit/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 12:55:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 12:55:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	de81e093a5b5b5215d8ff957aaf7cb2d62becd3fb9bc2166a4ff09e97cccf99b
TEKSTI	4de78f3dbfad7770080f98bc1c4e19324a8d6bfe40014cc73bf393e838ed943b
PAMJA	1f0f16647451085468ca6b0ef21bfcc5869634ca69b9cd337418e771d4adc091

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9bab937419704eace2e64b61c62a8c56480e28f4987944871b130c5b483d63f6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4cccf1fa7b0bcd85a4d154c0d42583811e3323ff976f0b5cd4a1ea64b7daae9e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9bab937419704eace2e64b61c62a8c56480e28f4987944871b130c5b483d63f6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > SHENDETI

Një grup i rrallë infeksionesh gjatë shtatzënisë rrit rrezikun e autizmit

14:55 : 29/09/2026 në SHENDETI



Një studim me 3,7 milionë persona në Suedi ka gjetur një lidhje mes një grupi infeksionesh të rrezikshme nëse merren gjatë shtatzënisë dhe rrezikut për zhvillimin e autizmit.

Sipas analizës, të kryer nga Instituti Karolinska, patogjenët e grupit TORCH, të cilët në raste të rralla kalojnë placentën dhe infektojnë fetusin, lidhen, te fëmijët që lindin me një infeksion të lindur, me një rrezik më të lartë si për autizëm, ashtu edhe për paaftësi intelektuale.

Rëndësia e studimit, të publikuar në JAMA Pediatrics, nuk qëndron aq te përmasat e fenomenit, (bëhet fjalë për infeksione të rralla, të cilat në pak raste transmetohen nga nëna te fëmija i palindur), sa te fakti se këto gjendje të rrezikshme gjatë shtatzënisë mund të parandalohen.

Grupi TORCH: Për çfarë bëhet fjalë?

Lexo edhe:

[Shqipëria, me rënien më të lartë të lindjeve në Europë në tri dekada](#)[Studimi: Foshnjat e lindura nga nëna me anemi kanë tru më të vogël](#)

Patogjenët e grupit TORCH (viruse, baktere dhe parazitë) janë veçanërisht të rrezikshëm gjatë shtatzënisë, sepse, në raste të rralla, janë në gjendje të kalojnë placentën dhe të infektojnë fetusin në fazat më delikate të zhvillimit të tij, kur ai ende nuk ka një sistem imunitar të maturuar.

Infeksionet e shkaktuara nga këta agjentë dihet se rrisin rrezikun për komplikacione afatshkurtra, si lindja e parakohshme, dhe afatgjata: ato mund të shkaktojnë vonesa në zhvillim, dëmtime neurologjike ose shqisore, epilepsi dhe kalcifikime në tru.

30 vjet vëzhgime

Studimi i ri ndoqi për tre dekada 975 persona që kishin marrë diagnozën e një infeksioni të

TË GJITHA



Një grup i rrallë infeksionesh gjatë shtatzënisë rrit rrezikun e autizmit

14:55 : 29/09/2026



Aksident në Cërrik, motoçikleta përplas nxënësen 14-vjeçare

14:55 : 29/09/2026



Prej 5 muajsh shqiptarët i kërkojnë dorëheqjen, Rama nga Brukseli: Reflektuam, krijuam 'pasqyrën inteligjente'!

14:46 : 29/09/2026



E rëndë në Akërn! 70-vjeçarja goditet me sëpatë në kokë, përdr'nohet dhe grabitet/ DETAJE

14:41 : 29/09/2026



Të shtënat gjatë aksionit antikanabis në Krujë/ Policia: Efektiviteti qëllor në ajër për të larguar kafshët e egra

14:31 : 29/09/2026



Shpërthimi te "AN OIL"/ Gjendja e 39-vjeçarit e rëndë, transportohet me helikopter drejt Tiranës

14:14 : 29/09/2026



Balla për hetimet për Vlorë Hysenin: Fikja e radarëve lajm "fake"

14:09 : 29/09/2026

lindur të grupit TORCH. Pjesëmarrësit u identifikuan përmes analizës së të dhënave shëndetësore dhe shkollore të 3,7 milionë personave, të lindur në Suedi nga viti 1987 deri në vitin 2021.

Ndjekja e këtyre personave për 30 vjet bëri të mundur të kuptohej se në sa raste diagnoza e sindromës TORCH në lindje lidhej më vonë me diagnoza të çrregullimeve të neurozhvillimit ose me vështirësi në rugëtimin shkollor.

Lidhja me autizmin

Te personat që ishin infektuar gjatë shtatzënisë, rreziku për autizëm rezultoi rreth tre herë më i lartë krahasuar me ata që kishin lindur pa infeksione. Probabiliteti për një diagnozë të mëvonshme të paaftësisë intelektuale ishte shtatë herë më i lartë, ndërsa ai për paaftësi të rëndë intelektuale ishte mbi 30 herë më i lartë.

Autorët theksojnë se, edhe pse bëhet fjalë për një rritje të konsiderueshme të rrezikut, kemi të bëjmë me rrezikun relativ për individin, pasi këto infeksione mbeten në përgjithësi shumë të rralla; edhe kur janë të pranishme, transmetimi i tyre te fetusit është i rrallë dhe jo të gjithë ata që lindin me këtë gjendje zhvillojnë autizëm.

Pavarësisht kësaj, kontributi i infeksioneve TORCH në rrezikun për autizëm është shumë i vogël: mendohet, për shembull, se ato lidhen me rreth 0,034% të rasteve të autizmit në Suedi dhe me 1,2% të rasteve të paaftësisë së rëndë intelektuale në atë vend.

Ndryshe është rreziku individual: rreth një në pesë fëmijë të lindur me infeksion të lindur TORCH mund të zhvillojë autizëm.

Ndërkohë, nuk u vërejtën lidhje mes këtyre infeksioneve dhe çrregullimeve të tjera të neurozhvillimit ose neuropsikiatrike, si ADHD-ja apo çrregullimi obsesiv-kompulsiv. Megjithatë, u vunë re (edhe te fëmijët me infeksione të lindura TORCH që nuk kishin marrë diagnozë për autizëm ose paaftësi intelektuale) vështirësi më të mëdha në shkollë dhe nota përgjithësisht më të ulëta se mesatarja, krahasuar me grupin e kontrollit.

Theksi te parandalimi

“Rezultatet tona sugjerojnë se disa infeksione të transmetuara te fetusit gjatë shtatzënisë mund të kenë efekte afatgjata në zhvillimin e trurit. Megjithëse këto infeksione të lindura janë të rralla, disa prej tyre mund të parandalohen, gjë që i bën të rëndësishme nga pikëpamja e shëndetit publik”, shprehet Renee Gardner, studiuese në Departamentin e Shëndetit Publik të Institutit Karolinska, e cila ka kontribuar në studim.

Për shembull, sigurimi që vaksinat (si ajo kundër rubeolës) të jenë të përditësuara përpara shtatzënisë, ruajtja e një higjienë të mirë të duarve dhe ambientit të shtëpisë, shmangia e mishit të pagatuar mirë dhe ushqimeve të tjera me rrezik, si dhe kryerja e të gjitha vizitave dhe ekzaminimeve prenatale, janë praktika të mira që ulin rrezikun e marrjes së këtyre infeksioneve.

Etiketa: [bebe](#)

Lajme të lidhura



Shqipëria, me rënien më të lartë të lindjeve në Europë në tri dekada

08:40 : 12/09/2026



Studimi: Foshnjat e lindura nga nëna me anemi kanë tru më të vogël

20:56 : 10/09/2026



Rrëmbëu mbësën 10-ditëshe nga spitali, arrestohet gjyshja në Itali

20:25 : 11/08/2026



Nga 900 në 500 milionë, bonusi i bebes po tkurret bashkë me lindshmërinë

17:53 : 21/07/2025



Denoncimi/ Sigurimet e Astrit Hados vonojnë pagesat për lejen e lindjes

15:11 : 16/06/2025



Veliaj e la pazarin përgjysmë, Anuela e "mbylli" me Isuf Berberin shportën e bebeve

19:53 : 09/06/2025



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.